

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-11/05

Prishtinë, më 28, 29 shtator dhe më 3 e 5 tetor 2005

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e drejtoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 80 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Miratimi i kërkesës së kryetarit të Kosovës lidhur me përgatitjet për bisedimet për statusin përfundimtar të Kosovës;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimet shëndetësore;
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për duhanin;
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ngrohjen qendrore;
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën e dhënies së koncesioneve;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kujdesin shëndetësor dhe emergjent;
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtarinë botuese dhe librin;
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për edukimin parashkollor;
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjuetinë;
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për markat tregtare;
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për minierat dhe mineralet;
13. Shqyrtimi i projekt strategjisë për energjinë në Kosovë 2005 – 2015;
14. Shqyrtimi i Raportit të buxhetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2005 dhe
15. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar 6+ për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratuan pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i kërkesës së kryetarit të Kosovës lidhur me përgatitjet për bisedimet për statusin përfundimtar të Kosovës

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me kërkesën e kryetarit të Kosovës, Ibrahim Rugova, për përgatitjet e bisedimeve eventuale për statusin përfundimtar të Kosovës, si dhe për emërimin e Grupit Negociator.

Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi që Kuvendi të distancohet nga bisedimet e ministrave të Qeverisë së Kosovës me homologët e tyre serbë.

Kuvendi të bëjë zyrtarizmin e pavarësisë së shtetit të Kosovës para se të fillojnë bisedimet me bashkësinë ndërkombëtare, për statusin përfundimtar

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi përgjegjësi më të madhe në përfaqësimin e politikës së jashtme

Të respektohet Deklarata e 2 Korrikut 1990 dhe referendumi i vitit 1991.

Gjylanze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se përkrah deklaratën e kryetarit të Kosovës, Ibrahim Rugova, për formimin e Grupit për bisedime lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës.

Vaton Surroi, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, tha se parimisht e përkrah deklaratën e kryetarit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, për përgatitjen e bisedimeve për statusin përfundimtar të Kosovës dhe emërimin e Grupit Negociator.

Mahir Jakhillar, në emër të Grupit Parlamentar 6+, tha se përkrah deklaratën e kryetarit të Kosovës, Ibrahim Rugova, por në Grupin Negociator duhet të përfshihet edhe një përfaqësues i këtij grupi.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e kërkesës (deklaratës) së kryetarit të Kosovës lidhur me përgatitjet për bisedimet për statusin përfundimtar të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte:

Për: shumica.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi kërkesën e kryetarit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, lidhur me përgatitjet për bisedimet eventuale për statusin përfundimtar të Kosovës dhe emërimin e Grupit Negociator.

Kryetari dha pauzë njëzet minuta.

Pas pauzës, në pamundësi për të zhvilluar punimet, **kryetari** e deklaroi seancën e sotme të mbyllur.

Më 29 shtator 2005

Vazhdim i seancës

Seancën e drejtoi Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi Naim Maloku, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Të pranishëm ishin 79 deputetë.

Në fillim të seancës, **kryetari** ia dha fjalën **Hashim Thaçit**, kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, i cili i bëri një vështrim zhvillimit të proceseve politike, që nga vitet e nëntëdhjeta e deri më tani.

Ai propozoi që Kuvendi i Kosovës të nxjerr një rezolutë, si vijon:

1. Kuvendi i Kosovës rikonfirmon vullnetin e popullit të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran;
2. Kuvendi i Kosovës merr qëndrim për mos negociim për pavarësinë e Kosovës, ngase vullneti i qytetarëve të Kosovës është i panegociueshëm;
3. Kuvendi i Kosovës kërkon që çdo vendim politik nga bisedimet apo marrëveshjet definitive të ratifikohen në Kuvendin e Kosovës, apo përmes referendumit nga qytetarët e Kosovës.

Kryetari tha se propozimi i z. Thaçi nuk është çështje e ngutshme, pra mund të shqyrtohet në procedurë të rregullt parlamentare.

Jakup Krasniqi propozoi një pauzë për t'u konsultuar lidhur me procedimin e propozimit të kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës.

Pas pauzës, **kryetari** fjalën ia dha **Hashim Thaçit**, kryetar i PDK-së, i cili propozoi arritjen e një konsensusi ndërmjet grupeve parlamentare lidhur me propozimin e tij. Ai kërkoi që Kuvendi të deklarohet sot apo në një seancë të veçantë.

Alush Gashi, kryetari Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se seanca duhet t'i vazhdojë punimet sipas rendit të ditës të miratuar, kurse nismën e PDK-së do ta shqyrtojnë dhe të deklarohen, pasi që ta marrin atë në formë të shkruar.

Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AAK, tha se janë për konsensus ndërmjet grupeve parlamentare për ta harmonizuar tekstin e Projektdeklaratës, të propozuar nga PDK-ja.

Veton Surroi, në emër të Grupit Parlamentar ORA, tha se e përkrahin përmbajtjen e nismës së PDK-së. Kuvendi nuk duhet të deklarohet sot lidhur me të, ngase ajo duhet të shqyrtohet në procedurë të rregullt, për t'i harmonizuar qëndrimet ndërmjet grupeve parlamentare.

Mahir Jakhillar, në emër të Grupit Parlamentar 6+, tha se edhe komunitetet e tjera i përkrahin qëndrimet e harmonizuar ndërmjet grupeve parlamentare.

Kryetari tha se propozimi i Partisë Demokratike të Kosovës duhet të parashtrohet në procedurë të rregullt parlamentare, në mënyrë që të gjitha grupet parlamentare t'i harmonizojnë qëndrimet lidhur me të dhe t'ia propozojnë Kuvendit.

Deputetët e Grupit Parlamentar të PDK-së, në shenjë pakënaqësie e lëshuan seancën.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimet shëndetësore

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Ai e ftoi ministrin e Shëndetësisë të jep sqarime lidhur me implikimet buxhetore të këtij projektligji.

Ministri **Sadik Idrizi** tha se për zbatimin e këtij ligji janë paraparë një milion e gjysmë euro për tri vjet, por me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional është rritur kostoja e zbatimit të tij. Qeveria i ka shqyrtuar implikimet e reja buxhetore për të cilat nuk ka mundur të sigurojë mjete shtesë. Andaj, i propozoi Kuvendit që ta shtyjë miratimin e këtij projektligji për ndonjë seancë tjetër.

Fatmire Mulhaxha, në emër të Komisionit funksional, tha se amendamentet që i ka propozuar janë të arsyeshme dhe të nevojshme që të përfshihen në këtë projektligj. Duhet të gjenden mjete shtesë për të mundësuar zbatimin e këtij ligji.

Pas këtyre diskutimeve, **Kuvendi**

V E N D O S I

Ta shtyj miratimin e Projektligjit për sigurimet shëndetësore për ndonjë seancë tjetër.

Në mungesë të kuorumit për të vazhduar punimet, **kryetari** e deklaroi të mbyllur seancën e sotme.

Më 3 tetor 2005

Vazhdim i seancës

Seancën e drejtoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Të pranishëm ishin 92 deputetë

Në fillim të seancës **kryetari** ia dha fjalën **Hashim Thaçit**, kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, që paraqiti qëndrimet e PDK-së lidhur me përgatitjet për bisedime për statusin përfundimtar të Kosovës. Ai insistoi që Kuvendi ta miratojë një deklaratë, që e kishte paraqitur dhe arsyetuar më parë.

Në emër të grupeve parlamentare, deputetët: **Alush Gashi, Bujar Dugolli, Teutë Sahatçiu dhe Xhezair Murati** e përkrahën nismën e Partisë Demokratike për nxjerrjen e një rezolute, me të cilën Kuvendi rikonfirmon vullnetin politik të qytetarëve për njohjen (shpalljen) e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran.

Kryetari dha pauzë të seancës gjatë së cilës kryetarët e grupeve parlamentare t'i harmonizojnë qëndrimet lidhur me projektrezolutën.

Pas pauzës, **Jakup Krasniqi** paraqiti qëndrimet nga konsultimet e kryetarëve të grupeve parlamentare, si vijon:

1. Të formohet Grupi i punës për harmonizimin e tekstit të Rezolutës në përbërje të: kryetarëve të grupeve parlamentare të Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese dhe të atij për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euro-Atlantike;
2. Të obligohet Grupi i Punës ta harmonizojë tekstin e Projekt-rezolutës brenda javës;
3. Kuvendi të mbajë seancë të posaçme gjatë javës së ardhshme, për ta miratuar rezolutën.

Kuvendi i miratoi qëndrimet e kryetarëve të grupeve parlamentare.

Kryetari, me kërkesë të deputetes Teutë Sahatçiu, e hodhi në votë kërkesën e Grupit Parlamentar ORA për ta radhitur në rend dite të seancës, si çështje të ngutshme grevën e punëtorëve të arsimit dhe të shëndetësisë.

Kuvendi me shumicë votash nuk e miratoi kërkesën e Grupit Parlamentar ORA.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për duhanin

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----67.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash e **miratoi** Ligjin për duhanin.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ngrohjen qendrore

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për ekonomi, tregti, industri, transport dhe telekomunikacion.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për-----58

Kundër-----?

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash e miratoi Ligjin për ngrohjen qendrore.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën e dhënies së koncesioneve

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion – Komision përgjegjës - raportues, që edhe e kishte propozuar këtë projektligj, i kishte rekomanduar Kuvendit ta miratojë Projektligjin në formën e propozuar.

Kryetari e hodhi në votë Projektligjin për procedurën e dhënies së koncesioneve.

Rezultati ishte si vijon:

Për-----61.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash e **miratoi** Ligjin për procedurën e dhënies së koncesioneve.

Kryetari dha pauzë dreke.

Pas pauzës, seancën e drejtoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Deputeti **Enver Hoxhaj** i paraqiti qëndrimet e Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji dhe të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale(që i kishin formular në takimin gjatë pauzës së seancës) lidhur me grevën e punëtorëve të arsimit dhe të shëndetësisë.

Dy komisionet parlamentare mendojnë se gjendja e punëtorëve të arsimit dhe të shëndetësisë është shumë e vështirë dhe e ftojnë Qeverinë e Kosovës të bisedojë me grevistët, për të marrë një vendim pozitiv dhe t'ia përcjellin Kuvendit të Kosovës.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kujdesin shëndetësor dhe emergjent

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Sadik Idrizi, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim ministri **Idrizi** shpjegoi strukturën e këtij projektligji, me të cilën normohet kjo materie.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Idrizi**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Naim Jerliu, Flora Brovina, Zylfije Hundozi, Fatmire Kollçaku, Nurishahe Hulaj, Zahrije Isufi dhe Teutë Hadri**. që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----63;

Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për kujdesin shëndetësor dhe emergjent. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale - Komision përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për edukimin parashkollor

Zëvendësministri Fevzi Berisha, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim zëvendësministri **Berisha** shpjegoi strukturën e këtij projektligji, me të cilin normohet kjo materie.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Berisha**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Naxhije Doçi, Sala Ahmeti, Mazllun Kumnova, Genc Gorani, Kamber Kamber, Flora Brovina dhe Fetah Berisha**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 63;

Kundër----- 1.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për edukimin parashkollor . Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport- Komision përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjuetinë

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri Tomë Hajdaraj, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim zëvendësministri **Hajdaraj** shpjegoi strukturën e këtij projektligji, me të cilin normohet kjo materie.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Hajdaraj**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Nimon Alimusaj, Sala Ahmeti, Myrvete Dreshaj, Genc Gorani, Nuran Malta, Kamber Kamberi, Naxhije Doçi, Nexhat Rexha dhe Mahir Jakxhillar**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 61;

Kundër----- 2.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e **miratoi në parim** Projektligjin për gjuetinë. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor - Komision përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

Kryesuesi e deklaroi seancën e sotme të mbyllur në orën 15:35 minuta.

Më 5 tetor 2005

Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit.

Në seancë ishin të pranishëm 92 deputetë.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për markat tregtare

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Bujar Dugolli, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri **Dugolli** shpjegoi strukturën e këtij projektligji, me të cilën normohet kjo materie.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Dugolli**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Fatmir Rexhepi, Bajrush Xhemajli, Xhevat Neziraj dhe Teutë Sahatçiu**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për-----79;

Kundër----- 3.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim** Projektligjin për markat tregtare. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri - Komision përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për minierat dhe mineralet

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ethem Çeku, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, ministri **Çeku** shpjegoi strukturën e këtij projektligji, me të cilën normohet kjo materie.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Çeku**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ibush Jonuzi, S ala B erisha, Gjylnaze S yla, T eutë S ahatçiu, B ehxhet B rajshori, B ajrush Xhemajli, Qibrije Hoxha, Fatmir Rexhepi dhe Nekibe Kelmendi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 75

Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim** Projektligjin për miniera dhe minerale. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti,

Industri - Komision Përgjegjës - Raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

Kryetari dha pauzë gjysmë ore.

Pas pauzës seancën e kryesoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë

11. Shqyrtimi i parë i Projekt-strategjisë për energjinë në Kosovë 2005-2015

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte Projekt-strategjinë për energjinë në Kosovë 2005-2015 para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ethem Çeku, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për miratimin e Projekt-strategjisë për energjinë në Kosovë 2005-2015, si dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e saj.

Në vazhdim, ministri **Çeku** theksoi se strategjia e energjisë është e orientuar nga koncepti i tregut, që i respekton dy parimet kryesore: a) *Demonopolizimin e infrastruktures energjetike korporatizimin e*

KEK-ut, dhe b) tregun e hapur për të gjithë pjesëmarrësit.

Rëndësia e sektorit të energjisë për zhvillimin e ardhshëm të Kosovës duhet të shikohet në dy aspekte : a) në funksion të krijimit të infrastrukturës së energjisë për zhvillim ekonomik dhe social duke ruajtur mjedisin dhe b) pesha që kanë resurset e konsiderueshme të energjisë primare, veçanërisht lignitit dhe shfrytëzimi racional i tij, në kontekstin e strategjisë së gjithmbarshme të zhvillimit të Kosovës.

Vizioni i strategjisë të energjisë të Kosovës është që sektori i energjetikës të jete:

- Teknologjikisht i avancuar;
- Financiarisht i qendrueshem;
- Pjese e sistemit rajonal dhe evropian të energjisë dhe
- Kontribues dhe jo shfrytëzues i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

Objektivat strategjike të zhvillimit të energjisë në periudhën 2005-2015 të ketë *kapacitet ëprodhimi të energjisë elektrike prej së paku rreth 1800 MW, për AF siguruar furnizimin e qëndrueshëm të konsumatorëve në Kosovë dhe për të eksportuar 30-50% të energjisë së prodhuar.*

Kosova me resurset e disponueshme energjetike, ka parakushte reale të bëhet faktor i rëndësishëm në tregun rajonal të energjisë. Zhvillimi ekonomik i Kosovës do të varet jo vetem nga posedimi i resurseve por edhe nga shfrytëzimi dhe menaxhimi efektiv i tyre.

Pas arsyetimit të Projekt-strategjinë për energjinë nga ministri **Çeku**, kryesuesi e hapi diskutimin.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Fatmir Rexhepi, Bajrush Xhemajli, Gazmend Muhaxheri, Mazllun Kumnova, Sabri Hamiti,**

Jakup Krasniqi, Gani Koci, Behxhet Brajshori, dhe Ibush Jonuzi, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, ministri **Ethem Çeku** iu përgjigj vërejtjeve të deputetëve.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votë miratimin e Projekt-strategjisë për energjinë në Kosovë 2005-2015 . Rezultati ishte si vijon:

Për-----50;
Kundër----- 4;
Abstenime----- 17.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës e miratoi Projekt-strategjinë për energjinë në Kosovë 2005-2015, por e obligon Qeverinë e Kosovës që t'i inkorporojë te gjitha vërejtjet e deputetëve gjatë diskutimit lidhur me të.

12. Shqyrtimi i Raportit të buxhetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2005

Kryesuesi e ftoi sponsorin ta arsyetonte raportin e buxhetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2005

Ministri Haki Shatri, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi raportin e buxhetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2005.

Në vazhdim, ministri **Shatri** theksoi se buxheti i vitit 2005 kap shumën 739.3 milion euro. Të hyrat janë paraparë kryesisht të jenë të hyra nga tatimet dhe doganat në shumë prej 544 milion euro dhe të hyrat komunale 34.80 milion euro. Në periudhën 8 -mujore të hyrat e gjithmbarshme janë realizuar 95.7%. Të hyrat e buxhetit qendror që janë realizuar 97.3 %, nga atë cilat: nga të hyrat tatimore, doganat dhe TVSH në kufi 100% janë realizuar, të hyrat në kufi, doganat 98, kurse të hyrat nga tatimi vendor që i inkason ose i mbledh administrata tatimore janë realizuar 105.1%. Të hyrat jo tatimore janë realizuar 80,7%. Të hyrat komunale janë realizuar vetëm 67.2%.

Shpenzimet e gjithmbarshme në periudhën 8 - mujore janë realizuar 81.7%. Në strukturën e shpenzimeve pagat dhe mëditjet janë paguar 98.5%. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve është realizuar 87.2%. Te kategoria e subvencioneve dhe transfero janë realizuar 84.6%. Shpenzimet kapitale janë realizuar 61.6%. Dinamika e ulët e shpenzimeve kapitale është një dukuri negative. Shpenzimi më i ngadalshëm se sa dinamika e paraparë mund të arsyetohet se buxheti i këtij viti është miratuar me 2 muaj vonesë dhe vetë procedura e fillimeve të shpenzimeve kapitale është mjaft e komplikuar

Raporti në pjesën e pasme ka të dhëna të hollësishme për shpenzimet sipas organizatave buxhetore dhe linjave buxhetore.

Pas arsyetimit të raportit të buxhetit të gjashtëmujorit të parë të vitit 2005 nga ministri **Shatri**, kryesuesi e hapi diskutimin.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me raportin e buxhetit dhanë këta deputetë: **Naser Osmani, Behxhet Brajshori, Jakup Krasniqi, Nazim Jashari, Safete Hadërgjonaj, Xhevdet Neziraj, Teutë Hadri, Shaban Halimi, Gani Koci, Zahrije Jusufi dhe Fatmire Mulhaxha**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund ministri **Shatri** iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve.

13. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar 6+ për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare

Kuvendi pas shqyrtimit të kësaj kërkesë mori këtë

V E N D I M

Deputeti **Husnija Beshkoviq** emërohet anëtar i Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, në vend të deputetes **Shpresa Murati**.

Pas përfundimit të rendit të ditës, **kryetarët** e grupeve parlamentare ia paraqitën Kryesisë së Kuvendit kërkesat për t'i radhitur në rend dite të seancës së ardhshme.

Kryesuesi tha se të gjitha këto kërkesa duhet të parashtrohen me shkrim, sipas procedurave të parapara me Rregulloren të punës së Kuvendit.

Kryesuesi e deklaroi seancën të mbyllur në orën 15:00.

E hartoi

Spektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Akademik Nexhat DACI
